

V E N D I M
Nr.320, datë 5.8.1997

PËR SHTESA DHE NJË NDRYSHIM NË PËRBËRJEN E KËSHILLIT DREJTUES TË RTSH

Në mbështetje të nenit 16, pika 11 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese" dhe të neneve 7 e 8 të ligjit nr.7524, datë 19.11.1991 "Për statusin e Radiotelevizionit Shqiptar", ndryshuar me ligjet nr.7569, datë 27.2.1992 dhe nr.8228, datë 31.7.1997, me propozimin e Komisionit të Përhershëm të Mjeteve të Informimit Publik.

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I :

I. Të miratojë shtesat në Këshillin Drejtues të Radiotelevizionit Shqiptar me përbërjen si vijon:

1. Fatos Lubonja
2. Natasha Sheshi
3. Gëzim Podgorica
4. Edi Mazi
5. Martin Leka
6. Ylli Pango
7. Dhimitër Gjoka
8. Plator Nesturi
9. Gaqo Bushaka
10. Aleksandër Frangaj

II. 1. Të lirojë nga detyra e anëtarit të Këshillit Drejtues të Radiotelevizionit Shqiptar zotin Luan Rama mbasi ka dhënë dorëheqjen, sepse është zgjedhur deputet i Kuvendit Popullor.

2. Të miratojë në përbërjen e Këshillit Drejtues të Radiotelevizionit Shqiptar zotin Alfred Dalipi në vënd të zotit Luan Rama.

Ky vendim hyn në fuqi me datën 5.8.1997.